



Pranuar / Dorezuar Prilmenoi/Prodato Received/Delivery	12.12.2023	3	viti god. year
Organ /Njesia Organ/Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicma Quantity
SKOPJE	7421/2023		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.426/2019

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e dhe vendosjen e ankesave i përberë nga; Arben Mehmeti, kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.55/2021, të datës 19.10.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative ka shqyrtue ankesën A.nr.426/2019 të datës 25.07.2019 të ankueses [redacted] me adrese [redacted] kundër organit të punësimit Gjykata Themelore në Prizren, në çështjen juridike "Kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 03.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.426/2019 të datës 25.07.2019, e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokolli I.GJA.nr.1/2019-86, i datës 10.06.2019, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Gjykatës Themelore në Prizren.

A r s y e t i m

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 07.12.2020, me numër A.nr.426/2019, ka nxjerr vendim me të cilin vendim ka refuzuar ankesën e ankueses si të pabazuar në ligj, duke e lenë në fuqi vendimin numër protokolli I.GJA.nr.1/2019-86, të datës 10.06.2019, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Gjykatës Themelore në Prizren.

Ankuesja [redacted] e pakënaqur me vendimin A.nr.426/2019 të datës 07.12.2020, të Këshillit, me datë 12.01.2021, ka ushtruar padi për konflikt administrativ tek Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Ndërsa Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 19.10.2023, ka nxjerr Aktgjykimin A. nr. 55/2021 me të cilin aktgjykim ka aprovuar kërkesë padinë e paditëses si të bazuar në ligj, duke anuluar vendimin A.nr.426/2019, të datës 07.12.2020, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kthyer çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje tek Këshilli.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin në vijim Kolegji i Këshillit) me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë duke u bazuar në relevancën që ndërlihen me objektin e kësaj ankesë ka administruar provat si në vijim: ankesën A.nr. 426/2019 të datës 29.07.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi I.GJA.nr.1/2019-71, i datës 03.05.2019, i Kryetarit të Gjykatës Themelore në Prizren; Akt Emërimit me numër reference 03-112-136, i datës 27.12.2012; Vendimi I.GJA.nr.1/2018-212, i datës 30.10.2018, i Kryetarit të Gjykatës Themelore në Prizren; Ankesa e datës 31.05.2019, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimi I.GJA.nr.1/2019-86, i datës 10.06.2019, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Fletedërgesë e datës 21.06.2019; Njoftimi i datës 11.09.2019, i Këshillit; Vendimi A.nr. 426/2019, i datës 07.12.2020, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimi A.nr. 397/2020, i datës 25.05.2021, i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Njoftim i datës 09.06.2021, i Këshillit; Padi e datës 12.01.2021, drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Aktvendimet A.nr.22/2021 dhe A.nr.55/2021 të datës 16.08.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Procesverbalet e datës 07.12.2020, 12.07.2023, 13.09.2023 dhe 19.10.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Përgjigje në ankesë me numër protokollit 3549/2019, e datës 14.08.2019.

Kolegji i Këshillit, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesja dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankueses [redacted] është e pabazuar, sepse:

Kolegji i Këshillit, fillimisht ka analizuar Aktgjykimin me numër A.nr. 55/2021, të datës 03.11.2023, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative, me të cilin aktgjykim ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit, [redacted] ankueses, ku me këtë aktgjykim ka anuluar vendimin A.nr.426/2019, të datës 07.12.2020, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kthyer çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje tek Këshilli dhe ndërlihur me obligimet që ndërlihen me këtë aktgjykim ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon që t'i bëhet pagesa e tri pagave mujore dhe shpërblimit jubilar me rastin e pensionimit sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive e Kosovës.

Bazuar në shkresat e lëndës del se Kryetari i Gjykatës Themelore në Prizren përmes vendimit me numër protokolli I.Gja. nr.1/2018-212 të datës 30.10.2018,i ka përfunduar mardhënien e punës ankueses për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, duke i njohur të drejtën e një page mujore të njëhershme me vlerën e pagës së fundit.

Po ashtu Kryetari i Gjykatës Themelore në Prizren përmes vendimit me numër protokolli I. Gja.nr.1/2019-71 datë 03.05.2019, ka nxjerr vendim me të cilin vendim ka refuzuar kërkesën e datës 24.04.2019, se ankueses si të pa bazuar në ligj, lidhur me pagesën e tri pagave dhe shpërblimin jubilar, në rastin e pensionimit.

Ankuesja [redacted] e pakënaqur me vendimin me numër protokolli i. Gja. nr.1/2019-71, të datës 03.05.2019, të Kryetarit të Gjykatës Themelore në Prizren, me datë 31.05.2019, ka parashtruar ankesë tek Komisioni për zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, ndërsa Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, përmes vendimit me numër protokolli I.Gja.nr.1/2019-86 të datës 10.06.2019, i ka refuzuar ankesën e ankueses si të pa bazuar në ligj, duke e lenë në fuqi vendimin e datës 03.05.2019, me numër protokolli I.Gja.nr.1/2019-71, të Kryetarit të Gjykatës Themelore në Prizren.

Kolegji i Këshillit ndërlidhur me objektin e ankesës dhe udhëzimeve të dhëna sipas aktgjykimit A.nr.55/2021, të datës 19.10.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka konstatuar që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015 sipas nenit 82 të saj, ndërsa ka pasur një kohëzgjatje prej tri vitesh siç parashihet me dispozitat e nenit 90 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, përcaktohet që: *"Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet"*, mirëpo neni 81 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, respektivisht paragrafi 1 ka përcaktuar që: *"Nga MPKK, Palët mund të tërhiqen tre (3) muaj para skadimit të vlefshmërisë së saj, përmes letrës rekomanduese. Tërheqja nga kjo MPKK, shpallet në Gazetën Zyrtare të Kosovës"*, bazuar në këtë Oda Ekonomike e Kosovës si nënshkruese e kësaj marrëveshje më datë 15.09.2017 ka njoftuar Ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale se për arsye ligjore tërhiqet nga zbatimi i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive. Neni 82 paragrafi 2 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive e Kosovës përcakton se: *"Nëse nga MPKK, pasi që i skadon afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga Palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit"*, mirëpo meqenëse njëri nga nënshkruesit e kësaj marrëveshje është tërheq nga zbatimi i saj tre muaj para skadimit e njëjta nuk vlen nga data e tërheqjes.

Meqenëse konstatohet se nga data 15.09.2017 Kontrata e Përgjithshme Kolektive e Kosovës nuk është e zbatueshëm, rrjedhimisht nuk mund të prodhojë asnjë pasojë juridike sepse më nuk është nënshkruar nga institucionet kompetente. Andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që ka konstatuar se marrëdhënia e punës së ankueses me rastin

e pensionimit i ka përfunduar më datë 01.11.2018, atëherë kompensimi i tri pagave me rastin e pensionimit dhe shpërblimit jubilar sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës nuk mund të bëhet nga se nuk ka bazë ligjore.

Kolegji i Këshillit, meqenëse konstaton që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës nuk është në fuqi, atëherë kompensimin me rastin e pensionimit të nëpunësve civil bëhet në pajtim me dispozitat e nenit 22 paragrafit 2 nën paragrafit 2.2 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe dispozitat e nenit 19 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë i cili përcakton që: *"Paragrafi 1. Sipas nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit në Shërbimin Civil, gëzon të drejtën e kompensimit". Paragrafi 2. Nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën e një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagesë së fundit"*, kështu që kryetari i Gjykatës Themelore në Prizren me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokolli I.Gja. nr.1/2018-212 të datës 30.10.2018 me të cilin ankueses i është njohur e drejta e kompensimit të një page mujore të njëhershme në vlerën e pagës së fundit, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë, kështu që pretendimet ankimore të ankueses janë të pabazuara.

Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se Vendimi me numër protokolli I.GJA.nr.1/2019-86, i datës 10.06.2019, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Gjykatës Themelore në Prizren përmes të cilit vendim ka refuzuar ankesën e ankueses, ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike andaj edhe si i tillë është lënë në fuqi.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, respektivisht bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.426/2019, datë 03/12/2023

Rushit KAJTAZI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses [REDACTED]
- Kryetarit të Gjykatës Themelore në Prizren;
- Arkivit të KPMShCK-së